


Pianoja e humbur e Sulltan

Abdylhamidit II

*Një projekt shumëdimensional i
kulturës dhe artit*

Sulltan Abdylhamiti ka një vend të veçantë në mesin e sulltanëve osmanë për interesin e tij mbi muzikën klasike perëndimore dhe veçanërisht dashurinë e tij për pianon dhe violinën. Ndërsa ishte ende një princ i ri, instrumentet muzikore automatike që takoi në Panairin e Parisit gjatë udhëtimit të tij në Evropë me xhaxhain e tij, Sulltan Abdülmeçid në 1867, i dhanë formë idesë së princit të ri për të blerë një piano që luante vetë.



Vite më vonë, kur edhe u bë sulltan Abdylhamiti realizojë ëndrrën e tij. Pianoja automatike e Sulltan Abdylhamitit, e cila u soll në Stamboll në vitin 1907, mendohej se kishte humbur; por në përfundim të hulumtimeve në terren të këtij projekti piano u gjet. Ndërsa kërkimet, artikujt e shkruar madje edhe dokumentet arkivore i çuan studiuesit në përfundimin se piano ishte një piano e zakonshme e murri, nga studimet në terren të këtij projekti zbuluan se kjo piano ndodhet në pallat dhe ishte një piano koncerti, një piano e madhe e njohur si një piano e madhe automatike. Ndonëse në arkivin osman ka informacion të detajuar për pianon si; (porosia e pianos, blerja, çmimi i saj, manuali i përdorimit etj.), asnjë hulumtim nuk ndihmoi në gjetjen e saj por u bënë vetëm hamendime arkivore dhe kjo mangësi e pengoi zbulimin e pianos dhe historinë e jetës reale dhe kulturës në pallat të asaj kohe.





Selçuk Alimdar, në librin e tij me titull "Muzika perëndimore në Perandorinë Osmane (2016)", bazuar në dokumentet arkivore argumenton se autopiano i është dhënë pallatit nga kompania ndërmjetëse (Kastner & Co) dhe se piano është "një auto-piano që mund të luajë automatikisht, në mënyrë programore". Gjithashtu, një nga gabimet e Alimdarit është se ky instrument është i markës amerikane Auto Grand Piano. Një hulumtim tjetër i cili ka të bëjë me këtë piano është edhe artikulli i Evren Kutlay me titull "Një rast historik i ndërveprimeve muzikore anglo-osmane: Auto-piano angleze e Sulltan Abdulhamid II". Fatkeqësisht, ky studim nuk mundi të shkonte më larg se dokumentet e arkivit, madje pretendonte se marka e pianos është Kastner&Co (pasi që kjo ishte e vetmja kompani ndërmjetëse) dhe dha informacione të gjata për pianot Kastner&Co, duke pretenduar se pianoja ishte prodhim anglez. Por studimet paraprake të këtij projekti tregojnë se kjo auto-piano që erdhi në pallatin osman nuk është një piano e murit; sepse Kastner&Co është një kompani që prodhon vetëm autopiano të murrit dhe kjo autopiano nuk është as markë amerikane dhe as britanike, siç thuhet në literaturë.





Por si rezultat i hulumtimeve të deritanishme, pianoja e cila supozohej e humbur e u gjet në Pallatin Beylerbeyi dhe kuptohet që është një auto piano madhështore e prodhuar nga fabrika M.F. RACHALS nga Hamburgu dhe ajo çfarë e vërteton këtë është emri i kompanisë i gravuar në pjesën e brendshme metalike të pianos. Kastner&Co, si kompani ndërmjetësuese ka luajtur rol në sjelljen e pianos në Stamboll dhe emri i kësaj kompanie është i gdhendur në brendësin e çelësit të pianos. Me qendër në Hamburg, M.F. Kompania Rachals është kompania që prodhoi auto-pianon e parë të madhe në botë në vitin 1903. Ndërsa manuali i përdorimit të pianos është gjithashtu i përfshirë në dokumentet në arkiv. Një zbulim tjetër përgjatë hulumtimit të pianos në Pallatin Beylerbey tregon se autopiano e Sulltan Abdulhamidit II është përdorur edhe në pritjet shtetërore në vitet 1950.

Po ashtu në pjesën e brendshme të pianos është gjetur kartëvizita e Vasil Yakovidis i cili është një importues i instrumenteve muzikore e që njëkohësisht kujdesej për mirëmbajtjen e pianove në pallate gjatë periudhës së Republikës, emrin dhe adresën e të cilit janë gjetur edhe në regjistrin e vitit 1951 të drejtorisë së punëve të Republikës. Kjo do të jetë një temë që do të thellojë kërkimin tonë se në cilat ftesa dhe ngjarje zyrtare është përdorur autopiano e Sulltan Abdylhamitit II në periudhën e Republikës.

Informacioni për repertorin brenda pianos është marrë nga kompania dhe në program është gjetur edhe himni që Nexhip Pasha ka shkruar për Sulltan Abdylhamitin II. Po ashtu nga kjo na bënë të kuptojmë se fabrika e cila nuk bënte prodhime me porosi atëkohë i dërgoj Sulltan Abdylhamitit II një piano të llojit të veçantë.



Duke pasur parasysh se në çfarë mase kultura osmane dhe trashëgimia kulturore u përhap gjatë historisë në gjeografinë ku shtrihej, ajo që tregon ndikimin evropian është pa dyshim himni “Hamidiye” i perandorisë së asaj kohe i luajtur në instrumente i cili u përhap në gjithë botën si rezultat i këtij ndikimi dhe perspektives kulturore të cilën e kishte Sulltan Abdylhamidit II e që cilësohej për një shije të madhe muzikore.



Detajet e tjera të këtij projekti do të prezantohet nga **Prof.Dr. Nuray Ocakli** në lidhje me historikun e sjelljes së pianon në Stamboll dhe mënyrës se si është përdorur gjatë viteve.



Me pastaj nga 32 veprat të cilat janë gjetur të regjistruara në pianon automatike, 10 nga ato do të luhen në piano në kohë reale nga **Prof. Dr. Tutu Aydınoğlu**.



QËLLIMI

- Rigjallërimi i një vepre historike 150-vjeçare që supozohej të zhdukej në Perandorinë Osmane, pavarësisht mendimit se kultura muzikore moderne nuk arriti kurrë në pallatin Osman.
- Njohja dhe përshkrimi në detaje i aventurës së pianos dhe marrëdhënia e saj me Sulltan Abdylhamitit II qysh nga fëmijëria e tij deri në vdekje.
- Zbulimi dhe promovimi i shijes së muzikës klasike perëndimore në pallat gjatë periudhës së modernizimit osman.



INSTITUTI JUNUS EMRE – QENDRA KULTURORE TURKE

PRISHTINE / PRIZREN / PEJË